



BSc Teknik Dentarë
Programi mësimorë i lëndës

Lënda	Aparate Ortodontike 1			
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi
	OBLIGATIV(O)	3	6	18
Ligjëruesi i lëndës	Prof. Asst. Dr. Miranda Sejdiu Abazi			
Asistenti i lëndës	Dr. Sc. Jeta Kiseri Kubati, Dr. Spec. Vesel Rrustemaj, Dr. Spec. Donika Peci			
Qëllimet dhe Objektivat	Qëllimi i lëndës është njohja e studentëve me fazat e zhvillimit të fytyrës, kafkës dhe pershkrimi morfologjiko-funksional i okluzionit, anomalitë e okluzionit, klasifikimi i aparateve ortodontike dhe parimete trajtimit ortodontik. Kursi do të ofrojë njohuri mbi parimet e ndërtimit të aparateve ortodontike dhe nevojat për aparatet ortodontike.			
Rezultatet e pritshme	Pas përfundimit të kënaqshëm të lëndës, studentët do të jetë në gjendje të: : <ul style="list-style-type: none">• 1. Të njohin parimet e ndërtimit të aparateve ortodontike si dhe përdorimin e terminologjisë së specializuar;• 1.1 Do të dinë të njohin klasifikimet e okluzionit dhe aparateve ortodontike, indikacionet dhe kundërindikacionet e trajtimit ortodontik, si dhe të gjitha fazat e ndërtimit të aparateve ortodontike;• 2. Të ndërtojnë aparate të ndryshme ortodontike, ti njohin avantazhet dhe disavantazhet e tyre, do të dinë të bëjnë dallimin në mes të trajtimit ortodontik tek fëmijët dhe tek të rriturit, si dhe do të mund të interpretojnë planin e trajtimit të mjekut;• 2.1 Të përzgjedhin dhe të përdorin materialet, aparatet dhe instrumentet e punës në përputhje me natyrën e punës duke respektuar udhëzimet, kërkesat për masat e sigurisë dhe ruajtjen mjedisit;• 3. Të lidhin tela të ndryshëm;			



	<ul style="list-style-type: none"> • 3.1 Të kenë njohuri rreth aplikimit të aparateve ortodontike nëkavitetin oral, si dhe përshtatjen dhe mirëmbajtjen e tyre • 3.2 Të përshkruajnë procesin e ndërtimit të aparatit të përfunduar; 	
<p>Përafrimi i rezultateve të të nxënit të lëndës me rezultatet e të nxënit të programit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikimi i terminologjisë në praktikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Programi BSc (Rezultati 2, 5): Ligjeratat ofrojnë njohuri teorike në Shkencat Stomatologjike dhe kjo u mundëson studentëve që të zbatojnë këto njohuri në praktikë. Kurset e komunikimit dhe prezantimet me gojë përmirësojnë aftësitë me shkrim dhe ato verbale 2. Vlerësimi i kërkesave në prodhimin e aparateve ortodontike: <ul style="list-style-type: none"> ○ Programi BSc (Rezultati 3, 6): Seancat laboratorike ofrojnë përvojë praktike; ○ Puntoritë e përzgjedhjes së materialeve ofrojnë përvojë praktike; 3. Zhvillimi i aftësive praktike: <ul style="list-style-type: none"> ○ Programi BSc (Rezultati 8, 10, 11, 12): Përfshin kurse teknologjike dhe seminare, që demonstrojnë përdorimin e teknologjisë; ○ Sesionet praktike dhe laboratorët e prodhimit, udhëzojnë studentët në prodhimin e aparateve ortodontike; ○ Në seancat praktike demonstrojnë procedurat e riparimit; ○ Bashkëpunim me profesionistë dentarë në klinikë. 	
<p>Përmbajtja</p>	<p>Plani javor</p>	<p>Java</p>
	<p>Definicioni, detyrat dhe qëllimet e lëndës. Rëndësia psikologjike dhe social -ekonomike e ortodoncisë;</p>	<p>1</p>
	<p>Historiku Ortodoncisë;</p>	<p>2</p>
	<p>Karakteristikat dhe rëndësia e marrjes së masës në ortodonci, rëndësia dhe krijimi i modeleve të studimit Instrumentet e përdorura për analizën e modelevetë studimit</p>	<p>3</p>
	<p>Metodat diagnostikuese dhe plani i trajtimit të anomalive ortodontike. Nxjerrja e dhëmbëve për arsye ortodontike. Analiza e rentgenit në ortodonci</p>	<p>4</p>



	Okluzioni normal – okluzioni ideal dhe artikulacioni	5
	Anomalitë e dhëmbëve dhe nofullave. Anomalitë ortodontike; Klasifikimi i tyre; Anomalitë edhëmbëve në veçanti; Anomalitë e pozitës së dhëmbit	6
	Kuize	7
	Anomalitë e dhëmbëve dhe nofullave. Anomalitë e numrit, formës, madhësisë dhe zhvillimit të strukturës së dhëmbëve;	8
	Anomalitë e dhëmbëve dhe nofullave. Anomalitë e harqeve të dhëmbëve;	9
	Malokkluzionet në planin sagital, transversal dhe vertikal;	10
	Etiologjia e malokkluzioneve – faktorët etiologjik local të malokkluzioneve;	11
	Etiologjia e malokkluzioneve – faktorët etiologjik të përgjithshëm të malokkluzioneve	12
	Anomalitë kraniofaciale dhe defektet të lidhura me lindjen;	13
	Presentimi i seminareve	14
	Vlerësimin përfundimtar	15
	Sesionet laboratorike	Java
	Zhvillimi i denticionit të qumshtit, denticionit të përhershëm dhe grafiku i eruptimit të dhëmbëve të përhershëm;	1
	Fiziologjia e lëvizjes së dhëmbëve;	2
	Marrja e masës dhe krijimi i modeleve të punës;	3
	Okluzioni fiziologjik;	4
	Malokkluzionet;	5
	Klasifikimi i anomalive ortodontike sipas Angel dhe etiologjia e tyre;	6
	Kuize, Projekte	7



	Përcaktimi i linjave orientuese në modele dhe analiza tredimensionale në planin horizontal, vërtikal dhe sagjital;	8
	Analiza e modeleve sipas autorëve: Pont, Korkhaus, Schmith dhe Schëarz;	9
	Analiza e rentgenit në Ortodonci (Ortopantomogrami);	10
	Krijimi i modeleve të studimit, fiksimi në okludator dhe artikulatorë;	11
	Punimi i komponentëve aktivë të aparateve ortodontike mobile;	12
	Punimi i komponentëve pasive të aparateve ortodontike mobile	13
	Konstruktimi i aktivatorit dhe bionatorit	14
	Vlerësimi praktikë	15
Metodat e mësimdhënies	Aktiviteti mësimor – Pesha (%)	
	Këto metoda janë përzgjedhur me kujdes, për të siguruar që studentët të zhvillojnë një kuptim të thellë të parimeve të aparateve ortodontike, ndërkohë që në të njëjtën kohë përmirësojnë aftësitë praktike.	
	1. Ligjerata: 20% <ul style="list-style-type: none">○ Qëllimi: Një kornizë e fortë teorike është thelbësore për ta kuptuar materialin e lëndës;○ Relevante për: Ligjeratat javore japin një gamë të gjerë të lëndës. Ligjeratat zhvillohen me saktësi maksimale, të qarta, për t'ua lehtësu të kuptuarit e koncepteve komplekse të lëndës;	
	2. Aftësitë praktike (Hands-on) 35% <ul style="list-style-type: none">○ Qëllimi: Të zbatojë njohuritë teorike në praktikë në prodhimin e aparateve ortodontike;○ Relevante për: I lejon studentët të zbatojnë teorinë në praktikë, të zhvillojnë aftësi dhe përvojë në botën reale laboratorike. Puna laboratorike i përgatit studentët për karrierë, duke i ndihmuar ata të fitojnë njohuri teorike dhe përvojë praktike;	



	3. Presentimi i seminareve 10% <ul style="list-style-type: none"> ○ Qëllimi: Të mësuarit në bashkëpunim; ○ Relevante për: Sesionet e planifikuara për prezantimin e seminareve 	
	4. Diskutimet në grup: 10% <ul style="list-style-type: none"> ○ Qëllimi: Diskutimi i risive në industrinë e Ortodoncisë; ○ Relevante për: Duke ndarë përvojat dhe njohuritë në grup, studentët mund të mësojnë nga njëri – tjetri dhe të fitojnë një dituri më të thellë të zhvillimve më të fundit në Ortodonci; 	
	5. Ligjerues të ftuar dhe punëtori: 10% <ul style="list-style-type: none"> ○ Qëllimi: Pjesëmarrja në leksione dhe punëtori është një mënyrë e shkëlqyer për ekspozimin ndaj ekspertizës së jashtme dhe përparimeve të reja në fushën ortodontike; ○ Relevante për: Folës të ftuar me përvojë Punëtoritë e rastit ofrojnë mundësi për të mësuar aftësi dhe teknika të reja nga ekspert me përvojë dhe për të qëndruar në hap me të rejat e fundit të industrisë. 	
	6. Detyra të shtëpisë, E- mësimi 15% <ul style="list-style-type: none"> ○ Qëllimi: Studenti duhet të përgatisë seancat e ardhshme laboratorike dhe detyra e tyre është të hyjnë në Moddle për të rishikuar mësimin e leksionit të mëparshëm. Përdorimi i këtyre burimeve maksimizon përvojën e të mësuarit nga shtëpia. ○ Relevante për: Qasjen në burimet online 	
	Totali	100 %
	Mënyrat e vlerësimit - Pesha (%)	
Metodat e vlerësimit	1. Provimet me shkrim: (20%) <ul style="list-style-type: none"> ○ Qëllimi: Të vlerësojë të kuptuarit e koncepteve, teorive dhe kornizave kryesore në ortodonci dhe aplikimin njohurive teorike në mjediset laboratorike. ○ Metoda e vlerësimit: Testet me shkrim- Vlerësimi i njohurive dhe aftësive për të shpejguar parimet bazë të prodhimit të aparateve ortodontike. 	



	2. Vlerësimi praktik - hands on: (35%) <ul style="list-style-type: none">○ Qëllimi: Të vlerësohet zbatimi i njohurive praktike;○ Vlerësimi i çdo ushtrimi në laborator;○ Vlerësimi do të bazohet në performancën e studentëve në laboratorin dentar;○ Studentët duhet të ndërtojnë 3 aparate ortodontike të lëvizshme në laborator;○ Vlerësimi praktikë, mat aftësinë e studentit për të kryer procedurat laboratorike në mënyrë të pavarur;○ Vlerësimet praktike përfshijnë prodhimin e aparateve ortodontike , të cilat duhet t'i plotësojnë standardet profesionale;○ Vlerësimi praktik kërkon nga studenti të jetë i aftë në riparimin e aparateve ortodontike. Gjatë këtyre vlerësimeve, cilësia dhe efektiviteti i riparimeve vlerësohen për të siguruar që studentët të kenë kuptuar teknikat e kërkuara për t'i kryer këto detyra në një mjedis profesional;
	3. Presentimi i seminareve: (10%) <ul style="list-style-type: none">○ Qëllimi: Organizimi i mendimeve për një prezentim përmirëson aftësinë e të shkruarit, ndërsa prezentimet në publik e rrisin besimin dhe aftësitë e komunikimit○ Metoda e vlerësimit: Prezentimet orale dhe punimi i eseve;
	4. Diskutimet në grup: (10%) <ul style="list-style-type: none">○ Qëllimi: Të vlerësojë aftësitë kërkimore të thelluara dhe analizën kritike në kërkimet më të fundit të Ortodontisë;○ Diskutimet në grup japin rezultate më të mira. Janë procese të bashkëpunimit, që gjenerojnë ide të reja, zgjedhin problem dhe përmirësojnë aftësinë e komunikimit;○ Metodat e vlerësimit: Pjesëmarrja në prezente○○ Meto
	5. Mësimi nga ligjëruesit e ftuar (10%) <ul style="list-style-type: none">○ Purpose: Të mësohet nga ekspertët përfshin shpërndarjen e njohurive, duke ofruar perspektivë unike dhenjohuri praktike○ Metoda e vlerësimit- ditari reflektues



	6. Detyrat e shtëpisë, E- mësimi (15%)		
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Detyrat që lidhen me mësimin elektronik. Përdorimi i teknologjisë dixhitale për të ofruar përmbajtje arsimore dhe lehtësimi i mësimnxënies interaktiv. ○ Përfshin kuize, video etj. 		
	Totali	100%	
Burimet dhe mjetet e konkretizimit	Mjetet		
	1. Tekstet shkollore dhe materialet tjera ndihmëse:		
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Meterialet efektive të studimit, duhet të jenë relevante, të sakta dhe të përditësuara, për të siguruar që studentët të jenë të pajisur me informatat më të reja, sikurse: <ul style="list-style-type: none"> ○ Tekste shkollore ○ Revista ○ Shënime nga ligjeratat ○ Artikuj online ○ Video ○ Burimet e multimedias 		
	2. Laboratori dentar, pajisjet laboratorike dhe materialet		
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Laboratori dentar me të gjitha pajisjet dhe materialet ofron kushte perfekte për punë praktike të shkëlqyer për teknike dentar. 		
	3. Klasat:		
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ilustrime për aplikime praktike të teorisë në skenarë të botës reale 		
	4.Kompjuter dhe projektor:		
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Video ○ Webinar and ëorkshope 		
ECTS Ngarkesa	Lloji i aktivitetit		
	1. Ligjerata	30 h	20%
	2. Laborator dentar	60 h	35 %
	3. Diskutime në grup dhe seminare	20 h	10 %
	4. Presentime	20 h	10 %
	5. Mësim nga të ftuarit	20 h	10%
	6. Mësim individual	30 h	15%
	Totali	180 h	100.0 %



Literatura	<ul style="list-style-type: none">○ 1. Federico V. Tenti. Atlas i aparateve ortodontike fikse dhe të lëvizshme: Si dhe pse t'i zgjedhim të gjitha teknikat për të gjitha filozofitë. Prishtinë, 2004.○ 2. Tony Johnson, David G. Patrick, Christopher E. Stokes, David G. Wildgoose, Duncan J. Wood. Basics of Dental Technology. A Step by Step Approach. Wiley Blackwell 2016.○ 3. Milan Markovic-Ortodncija izdavac ortodontska sekcija Srbije○ 4. Clinical Orthodontics-Current concepts, goals and mechanics (2nd Edition)
Kontakti	Prof. Asst. Dr. Miranda Sejdiu Abazi miranda.sejdiu@ubt-uni.net

Parakushtet për lëndën

Kjo lëndë nuk ka parakushte.



Vlerësimi i Kompetencës

Që klasa të arrijë një nivel Master të të mësuarit, studentët duhet të përgatiten duke e lexuar materialin e dhënë, të plotësojnë të gjitha detyrat e caktuara për secilën klasë. Studentët do të vlerësohen për pjesëmarrjes si:

- Pjesëmarrje e plotë në aktivitetet e klasës dhe në punën në grup .
- Pjesëmarrja në diskutimet në klasë (pa dominuar bisedën).
- Demonstrimi i të kuptuarit të përmbajtjes së materialit të lexuar.
- Ofrimi i mendimit kritik për materien e lëndës.
- Shtimi i ideve në diskutimin në klasë.
- Duke ndihmuar të tjerët të sqarojnë një ide.
- Mbështetja e të tjerëve ndërsa ata ndajnë idetë e tyre dhe flasin në klasë.
- Ngritja e ideve dhe pyetjeve të reja.
- Mbërritja në kohë dhe qëndrimi gjatë gjithë orës së mësimit.

Politika e pjesëmarrjes

Studentët pritet të ndjekin të gjitha ligjëratat dhe ushtrimet. Rëndësia e frekuentimit në klasë reflektohet në përqindjen e notës që lidhet me pjesëmarrjen. Ju nuk mund të merrni nota pjesëmarrjeje nëse nuk jeni në klasë. Nëse keni një urgjencë dhe nuk mund të merrni pjesë në klasë, ju lutem më dërgoni e-mail paraprakisht për të më njoftuar. Klasa do të fillojë në kohë për të respektuar angazhimin e të gjithëve. Nëse jeni vonë, ju lutemi hyni në klasë të qetë. Notat e pjesëmarrjes do të zbriten për vonesë.

Studentët duhet të jenë prezent në së paku 80% të ushtrimeve.

Rregullore Mësimore

Pjesëmarrja në mësim

Kolegji UBT merr përgjegjësinë e trajnimit të profesionistëve të ardhshëm në standardet më të larta. Një nga këto standarde është marrja e përgjegjësisë për veprimet personale. Nëse një student mungon nga mësimi veçanërisht në një sesion, studenti i ka humbur ato udhëzimeve përgjithmonë. Ato, asnjëherë nuk mund të përsëriten. Kur një student vonohet në mësim, i gjithë mësimi ndërpritet. Ndërprerje të tilla nuk do të tolerohen. Studentët kanë një përgjegjësi dhe një kontratë për të qëndruar në klasë gjatë gjithë kohëzgjatjes së sesioneve, për çdo ditë. Studentët që largohen nga sesionet para kohe, edhe nëse largohen me leje, shkaktojnë probleme disiplinore që nuk do të tolerohen.

Ju bëtë një kontratë me UBT-të për të qenë në klasë dhe të vëmendshëm gjatë gjithë procesit mësimor. Çdo student duhet të jetë në çdo sesion, çdo ditë që është planifikuar, gjatë gjithë semestrit. Të gjitha sesionet mësimore fillojnë në kohën e tyre të përcaktuar në orarin e mësimit.



Të gjitha sesionet fillojnë dhe përfundojnë në kohën e tyre të përcaktuar në orarin e mësimit. Çdo student që largohet para kohe nga sesioni mësimor do të llogaritet se mungon.

Pajisjet elektronike

Është shpërqëndruese për të gjithë në klasë kur telefonat mobil cingërrojnë gjatë orës së mësimit. Kjo është edhe më e keqe nëse ndodhë gjatë një testi ose kuizi. Meqenëse kjo është një klasë dhe jo një dhomë për të dëgjuar ose/dhe për të parë pajisje elektronike si telefonat inteligjent, laptopë personalë dhe/ose pajisje të tjera elektronike, ato nuk do të lejohen.

Klasa do të jetë një zonë pa telefona mobil. Nëse duhet të sillni një telefon mobil në klasë, ai duhet të fiket ose të formatohet në vibrim. Është shpërqëndruese për një klasë që studentët vazhdimisht t'i përgjigjen telefonave mobil gjatë orës së mësimit. Nëse absolutisht duhet t'i përgjigjeni thirrjes, dilni nga klasa. Një student, i cili pranon thirrje gjatë orës së mësimit do t'i kërkohet të largohet nga mësimi. Pajisjet e dëgjimit nuk do të lejohen në klasë për asnjë arsye.

Testet dhe kuizet

Testet dhe kuizet zakonisht caktohen në fillim të mësimit. Testet dhe kuizet janë një nga mënyrat që mësimitdhënësit masin dijen e një studenti. Mospjesëmarrja në teste ose kuize ndërhyjnë në këtë proces. Kolegji UBT nuk i shpërblen studentët që nuk marrin pjesë në teste ose kuizet e tyre në kohë; andaj, mësimitdhënësi nuk mund të lejojë studentët të bëjnë teste ose kuize pas afatit.

Testet dhe kuizet duhet të bëhen nga secili student, çdo student i cili kërkon ndihmë ose ndihmon studentët tjetër gjatë një testi ose kuizi, do të largohen nga testimi dhe do të vlerësohen me zero për atë test apo kuiz. Është përgjegjësi e studentit që të përgatitet për teste dhe kuize në çdo kohë. Është përgjegjësi e studentit të dijë se kur ka teste ose kuize që duhet të marrë pjesë.

Seminaret dhe projektet

Seminaret dhe projektet duhet të bëhen në kohën e studentit jo gjatë orës së mësimit.

Asnjëherë mos lejoni që një student tjetër të kopjoj seminaret dhe projektet tuaja.

Asnjëherë mos kopjoni seminaret dhe projektet e një studenti tjetër.

Datat e dorëzimit të punimeve

Një gjë që të gjithë profesionistët duhet të mësojnë është të jenë me kohë në punë. Arsyetimet nuk e bëjnë studentin dhe mësimitdhënësin të ndjehen më mirë për kohën e tyre të humbur. Për të gjitha detyrat e dhëna, jepet një kohë e mjaftueshme për t'u përfunduar, dhe e gjithë puna duhet të realizohet në kohën e përcaktuar nga mësimitdhënësi. **Asnjë vonesë në realizim e punimeve nuk do të pranohet.**



Kodi i veshjes

Profesionistë duhet të vishen siç duhet. Çdo student që nuk vishet siç duhet gjatë orarit mësimor nuk do të lejohet të marrë pjesë në aktivitetet mësimore.

Sjellja

Studentët në Kolegjin UBT duhet të mësojnë të punojnë në grupe, pavarësisht përbërjes së grupit. Toleranca, mirësjellja, respekti dhe një mjedis i qetë kërkohet në klasë.

Të gjithë studentët pritet të jenë të respektueshëm ndaj studentëve të tjerë dhe ndaj mësimdhënësit gjatë orës së mësimit dhe në trajtimin e çështjeve të klasës. Sjellja mosrespektuese do të ndikojë në notën tuaj të pjesëmarrjes. Shembuj të sjelljes me respekt në klasë përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Dëgjimi i njëri-tjetrit dhe shkëmbimi i ideve.
- Mbërritja dhe largimi sipas orarit të klasës, përveç rasteve kur ka urgjencë.
- Fikni zilen e celularit dhe nuk merrni telefonata në klasë.
- Flisni në mënyrë që të tjerët të dëgjojnë dhe kuptojnë atë që po thoni.
- Angazhimi në diskutimin në klasë (shmangia e bisedave anësore gjatë klasës dhe dominimi i diskutimit në klasë).
- Të dëgjuarit (jo duke folur) kur mësuesi ose studentët e tjerë po i drejtohen klasës.
- Puna në bashkëpunim me një grup të caktuar ose të përzgjedhur.
- Përfundimi i punës së klasës në kohë.
- Përqendrimi në temat e klasës dhe jo në çështje personale apo punë që nuk kanë lidhje me klasën.
- Shikimi i kompjuterit dhe/ose celularit tuaj vetëm kur lidhet me punën në klasë.
- Ngritja e pyetjeve kur mungon sqarimi për punën në klasë.

Pandershmëria Akademike

Shkeljet e Integritetit Akademik përfshijnë, por nuk kufizohen, në veprimet e mëposhtme:

- Mashtrimi në provim.
- Plagjiatura.
- Të punoni së bashku në një detyrë individuale, seminar ose projekt kur mësimdhënësi në mënyrë specifike e ka ndaluar këtë.
- Dorëzimi i të njëjtit punim tek më shumë se një mësimdhënësi ose lejimi i një individi tjetër të marrë identitetin e tij me qëllim të përmirësimit të notës.